



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_ Prot .

Vlorë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “SEKTORI I BORDIT TE KULLIMIT DHE UJITJES, BLERJE KARBURANT”, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë”. Karburante kodi 09100000-0;**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 7,095,833 (shtatë milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.**

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbështetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me

*përrjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

---

**7,095,833X 0.4=2,838,333 (dy milion e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre )lekë pa tvsh.**

2.2.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit.

Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëqë dy bilancet e njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. (Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e këtij kriteri, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm në procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të ligjit nr.25/2018 ”Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësitë e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet përkatësisht **1,419,167 (një milion e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.**

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, dhe

të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe pikës 4/b të nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë të Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës. Për shkak të rëndësisë që ka vet Autoriteti Kontraktor, llojit të mallit objekt prokurimi, i rëndësishëm për kryerjen e detyrave funksionale dhe profesionale të AK, me qëllim që të hyjmë në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomikë seriozë në treg, me performancë të mirë e të vazhdueshme, aplikojmë marzhin maksimal të vlerës së parashikuar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë *Licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet*”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë*” nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizë ose raport analizë i cilësisë së karburantit, lëshuar nga ISHTI, lëshuar jo më heret se 30 ditë nga dita e hapjes së ofertës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, gërma c pika 6 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.4. Operatori/et Ekonomik duhet të ketë minimumi dy pika furnizimi të rregullt (distributor) në territorin e Bashkisë Vlorë. (Të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil

(ekstrakti tregtar i QKR-se ose dokument tjetër ligjor.) Shërbimi në pikat e furnizimit duhet të sigurohet për 24 orë në çdo ditë të javës.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Në bazë, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

#### 2.3.5. Certifikat ISO:

- a) **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise(e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

#### **Argumentimi:**

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Kodin të punës, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 date 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”.

**2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, autobot për raste emergjente, i cili duhet të jetë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;**

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.
- kolaudimin,
- *certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).*

- fotografi të mjetit te paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit) .

*Shënim:* Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë leje mjedisore të tipit B të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin nenit 40 dhe 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

2.3.8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të cilës duhet te deklarojë se merr përsipër furnizimin 24 orë në çdo ditë të javës si edhe të paraqesë një deklaratë ku duhet të kryejne furnizimin e sasisë se karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar për çdo automjet të Autoriteteteve Kontraktore dhe furnizimin me autobot në rast nevojë të AK-së.

**Argumentim:**Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikes 8 te nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, per te garanuar permbushjen me sukses te kontrates nga OE dhe dhenia e sigurise AK-se qe kontrata do te realizohet sipas kerkesave.

2.3.9.Referuar VKM-se Nr 561 date 29.07.2016“Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se ofron një ndërfaqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Kjo ndërfaqe e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogaria elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.

**Argumentim:**Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikes 8 te nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, per te garanuar permbushjen me sukses te kontrates nga OE dhe dhenia e sigurise AK-se qe kontrata do te realizohet sipas kerkesave.

*Njësia e prokurimit vendosi unanimisht mmiratimin e dokumentave të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën:29/04/2024*

**Bashkëlidhur këtij procesverballi:**Dokumentat e tenderit.

**NJËSIA E PROKURIMIT**